



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.677/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.09.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Morava-L” shpk, në procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozime”, me Nr.REF-25130-08-30-2017, me objekt Loti I: “Blerje material per ngrrohje, dru zjari”, me fond limit 5.728.333, zhvilluar më datë 11.09.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Maliq.

Autoriteti kontraktor:

Bashkia Maliq
Bulevardi “Rinia”

Ankimues:

“Ardit” shpk
Maliq, Libonik, Drithas, Lagjia periferike, objekt në zonën kadastrale nr.1553, nr.pasurie 294/700.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjeve, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I


Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.



II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 31.08.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për propozime”, me Nr.REF-25130-08-30-2017, me objekt Loti I: “Blerje material per ngrohje, dru zjari”, me fond limit 5.728.333, zhvilluar më datë 11.09.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Maliq.

II.2. Në datën 11.09. 2017 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

III.3 Në datën 14.09.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

“Mufali” shpk	nuk ka paraqitur ofertë	
“M.B Kurti” shpk	nuk ka paraqitur ofertë	
“Morava-L” shpk	4.910.00 lekë	kualifikuar
“Ardit” shpk	5.690.000 lekë	skualifikuar
“Gjergj Buça”	5.695.600 lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 19.09.2017 operatori ekonomik “Ardit” shpk kundërshton vendimin e KVO-së, në mënyrë të përmbledhur me argumentet se:


“Operatori ekonomik “Morava-L” shpk është paraqitur në këtë tender me një kontratë shfrytëzimi, sipas kërkesës së kritereve të veçanta të kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 2.

Kontrata, e cila është paraqitur si dokument për kriteret e kualifikimit, është një kontratë e lidhur mbi një prokurë të posaçme, me nr.rep.8913 dhe nr.kol.5261, data 10.11.2016; ku subjekti “Morava-L” shpk është përfaqësuesi i autorizuar i “Ardit” shpk për ankandin me objekt “Dhënië në shfrytëzim të ekonomisë pyjorë Përparimaj, Dardhë, për heqjen e drurëve të shtrembër dhe rigjenerimin e parcelës 101a Bashkia Devoll”.

Në bazë të kësaj prokure, subjekti “Morava-L” shpk (përfaqësuesi), nuk gëzon të drejtën për të paraqitur këtë kontratë si kontratë shfrytëzimi dhe tregtimi të materialit drusor në një tender publik, pa pëlqimin e subjektit “Ardit”shpk (i përfaqësuar). Kjo kontratë i jep të drejtën subjektit “Morava-L” shpk, vetëm për pjesëmarrjen në ankandin e zhvilluar nga Bashkia Devoll për shfrytëzimin e materialit drusor. Në rastin konkret subjekti “Ardit” shpk nuk e ka autorizuar subjektin në fjalë.

Për këtë arsye kërkojmë që ky dokument i dorëzuar nga subjekti “Morava-L” shpk, të cilësohet i paligjshëm dhe kjo ofertë të refuzohet”.

II.5. Në datën 26.09.2017, pala ankimuese operatori ekonomik “Ardit” shpk, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtat pretendime si pranë autoritetit kontraktor.



III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Ardit” shpk mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorit ekonomik “Morava-L”shpk, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se:

III.1.1. Në ankimin drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik, operatori ekonomik “Ardit” shpk, pretendon për kualifikim të padrejtë të operatorit ekonomik “Morava-L”shpk, por nuk ngre asnjë pretendim mbi skualifikimin e tij.

III.1.2. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), me titull “Të drejtat e personit të interesuar” parashikon se: *“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin”.*

III.1.3. Në Vendimin KPP 7/2013, Komisioni i Prokurimit Publik është shprehur se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë) se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga

ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Neni 63, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (përkundrejt atij imagjinar) nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Kjo praktikë e KPP tashmë është konsoliduar edhe nga vendimmarrja gjyqësore, duke u lënë në fuqi përmes vendimesh përfundimtare.

III.1.4. Duke analizuar rastin në shqyrtim, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk legjitimohet, pasi interesi i tij i ligjshëm, nuk ka sesi të dëmtohet vetëm nga kualifikimi i ofertës së operatorëve të tjerë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi, përse kohë ankimuesi nuk ngre pretendime për skualifikimin e ofertës së tij. KPP vlerëson se ankimuesi do të legjitimohej në interesin e tij, në qoftë se në ankim bashkë me pretendimin për operatorin e kualifikuar, do të rendiste edhe pretendimin për skualifikimin e ofertës së tij.

Rrjedhimisht, pretendim i operatorit ekonomik “Ardit” shpk nuk merret në shqyrtim.

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Ardit” shpk për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozime”, me Nr.REF-25130-08-30-2017, me objekt Loti I: “Blerje material per ngrohje, dru zjari”, me fond limit 5.728.333, zhvilluar më datë 11.09.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Maliq.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për shqyrtimin e mosmarrëveshjes administrative.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1518 Protokoll; Datë 26.09.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha